

VENDIM
Nr. 156, datë 7.10.2020

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN SHTATOR 2020

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përparësive me nr. 105/3 prot. datë 2.10.2020, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, për muajin shtator 2020,

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën e saj nr. 8326 prot., datë 25.9.2020, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin shtator 2020, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Energjia e blerë në tregun e parregulluar, për plotësimin e nevojave për mbulimin e kërkesës për furnizimin e klientëve FMF, është në sasinë mesatare të ponderuar prej 203,170 MWh dhe në vlerën mesatare të ponderuar prej 1,532,015,552 lekë ose 7.320 lekë/kWh.

- FTL sh.a. ka realizuar dy procedura blerje të energjisë elektrike, respektivisht për plotësimin e nevojave të “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a.

- Bazuar në kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2020, janë vlerësuar sa ato të vitit 2019.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit: bazuar në vendimin nr. 198, datë 12.12.2019, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020”, është 0.75 lekë/kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV: bazuar në vendimin nr. 199, datë 12.12.2019, të Bordit të ERE-s, “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s, nr. 268, datë 21.12.2018, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2020”, është 1.5 lekë/kWh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF, për muajin shtator 2020, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Shtator 2020

Shtator 2020		Aplikimi FSHU sh.a.		Përlllogaritjet e ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	7.320	7.487
Pr	Krthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.22	0.22
	Çmimi mesatar i blerjes në përdorim të relevante	Leke/kWh	7.54	7.71
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA		Leke/kWh	11.58	11.75

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës përlllogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionit të përcjellë nga FTL sh.a., si dhe vlerësimeve të ERE-s sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin shtator 2020, të jetë 11.75 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, prej 11.75 lekë/kWh, për muajin shtator 2020.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti